



| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery | 17.11.2021 | viti god year | 1 |
| Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKANSHCK | 5500/2021 | | 113 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.851/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti- anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.851/2021 të datës 07.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Qendra Korrektuese për femra në Lipjan, Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për Këshillim dhe votim me datë 17.11.2021 mori këtë:

V E N D I M

I. HEDHET poshtë si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.851/2021 e datës 07.10.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, i cili sipas kontratës së punës të datës 02.02.2019 është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën “Zyrtar Korrektues”, me datë 04.10.2021 ka parashtruar ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës kundër vendimit numër:214/18 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të datës 23.08.2018 me pretendimet ankimore se Drejtori i Përgjithshëm pezullimi i gradimit të njëjtit është bërë në mënyrë selektive duke e dëmtuar ankuesin, ndërsa nuk është pezulluar i gjithë konkursi.

Komisioni për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 06.10.2021 ka nxjerr vendimin me të cilën e ka shpallur vetën jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 04.10.2021 ndërsa përmes e-mailit të datës 06.10.2021 e ka njoftuar ankuesin dhe po ashtu ankesën e ankuesit së bashku me vendimin e datës 06.10.2021 të Komisioni për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave e ka përcjellë tek organi kompetent, respektivisht në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.05.2021 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Këshilli me datë 19.10.2021 me numër protokollit 5091/2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 07.10.2021 me numër protokollit 4929/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 04.10.2021; E-mailin e datës 03.09.2021 dërguar nga ankuesi për Vendimin e datës 23.08.2018 dhe numër: 214/18 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; vendimin e datës 24.07.2018; kopjen e konkursit për pozitën mbikëqyrës; Vendimin e datës 06.10.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të ankesave; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.10.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 19.10.2021; E-mailin e datës 19.10.2021 dërguar nga zyrtarja për KPMSHCK; Kontratën e ankuesit të datës 02.02.2019; përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e ankuesit;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e jashtëafatshme, sepse:**

Me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2021 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: *“Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë”*, nga rrjedhe se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe ligjeve të veçanta.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se me datë 24.07.2018 Kryesuesi i Komisionit Rekrutues ka nxjerr vendim me të cilin ankuesi është përzgjedhur si kandidati me më së shumti pikë për pozitën Mbikëqyrës në Qendrën Korrektues në Lipjan, mirëpo Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues, përmes vendimit të datës 23.08.2018 me numër 214/18 ka anuluar procedurat për përzgjedhjen e ankuesit, ndërsa në kërkesën e Këshillit përmes përgjigjes në ankesë nëse ankuesi ka parashtruar ndonjëherë më parë ankesë kundër vendimit të datës 23.08.2018 me numër 214/18, mirëpo në bazë të provave të ofruara nga institucioni punëdhënës është gjetur se ankuesi asnjëherë nuk ka ushtruar të drejtën e ankesës kundër vendimit të datës 23.08.2018 përveç ankesës së parashtruar pas tre (3) vitesh me datë 06.10.2021 e cila në pajtim me Ligjin e Procedurës Administrative është përcjell në Këshill me datë 07.10.2021 2021, andaj mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill me datë 07.10.2021 respektivisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e datës 04.10.2021 është e jashtëafatshme siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 125 paragrafi 1 i cili përcakton se: *“Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”)”* si dhe neni 127 paragrafi 1 i cili përcakton se: *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”*, pasi që ankesa është parashtruar pas kalimit të afat prej më shumë se tre (3) vitesh.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me A.nr.851/2021

Flakron GASHI

Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Esmet SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Njësisë së Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;*
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*

